

02.05.06
[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPERISE

MINISTRIA E MBROJTJES

INSTITUTI I SIGURIMEVE
SHOQERORE

Nr. 570, date 2 / 5 / 2006

Nr. 643 /, date 25 / 04 / 2006

U D H E Z I M

PER

ZBATIMIN E VKM NR.69, DATE 27.1.2006 "PER MENYREN E
LLOGARITJES SE TRAJTIMIT TE VECANTE FINANCIAR TE EFEKTIVAVE,
OFICERE DHE NENOFICERE, LUNDRUES TE NENDETESEVE DHE
POLUMBAREVE TE FORCAVE DETARE, NE PENSION"

Ne mbeshtetje te pikes 4, te nenit 102 te Kushtetutes, dhe te Vendimit te Keshillit te Ministrave nr. 69, date 27.01.2006, "Per menyren e llogaritjes se trajtimit te vecante financiar te efektivave, oficere dhe nenoficere, lundrues te nendeteseve dhe polumbareve te Forcave Detare, ne pension",

UDHEZOJME:

1. Personat qe kane plotesuar, ose plotesojne kushtet e perfitimit sipas nenit 4 te ligjit nr.9361 date 24.3.2005 "Per nje trajtim te vecante financiar te efektivave oficere dhe nenoficere lundrues, te nendeteseve dhe polumbareve te Forcave Detare ne pension", terheqin dhe paraqesin ne Drejtorine Rajonale te Sigurimeve Shoqerore/Deget e Sigurimeve Shoqerore (DRSSH/DSSH) ku banojne, formularet e kerkeses per perfitim.

DRSSH/DSSH, pasi e rregjistron kerkesen (Mod.1), se bashku me certifikaten personale me fotografi, brenda 5 diteve nga momenti i paraqitjes se kerkeses, i nis per ne Drejtorine e Perfitimeve ne ISSH dhe kjo e fundit brenda 5 diteve, i dergon ne Ministrine e Mbrojtjes ne Drejtorine e Burimeve Njerezore, Arsimimit, Marredhenieve me Publikun dhe Informimit.

2. Drejtoria e Burimeve Njerezore, Arsimimit, Marredhenieve me Publikun dhe Informimit ne Ministrine e Mbrojtjes, ploteson

formulare Mod.2, Mod.3 dhe se bashku me dokumentacionin e ardhur nga ISSH, brenda 30 diteve nga momenti i mbërritjes, i nis zyrtarisht prane Drejtorise se Perfitimeve ne ISSH dhe kjo e fundit i dergon ne DRSSH/DSSH brenda 5 diteve.

3. Per llogaritjen e trajtimit financiar te personave perfitues, do te merren per baze:

Vjetersia e sherbimit te lundrimit:

- Vitet kalendarike te lundrimit me nendetese, (vite, muaj, dite)
- Vitet kalendarike si polumbar, (vite, muaj, dite)

Paga referuese e cila perbehet nga:

Paga baze per grade sipas viteve te sherbimit e ushtarakut aktiv te se njejtës grëde, ne momentin e lindjes se te drejtes per kete trajtim te veçante financiar.


Per efekt te llogaritjes se pages referuese, te merret funksioni, grada, e fundit si lundruës nenujes.


Kur funksionet organike, në çastin kur oficerët dhe nënoficerët e nëndetëseve dhe polumbarët kanë dalë në rezervë, në lirim ose në pension pleqërie, nuk ekzistojnë më në strukturën e Forcave të Armatosura, Ministri i Mbrojtjes, për efekt të pagës referuese, bën njësimin e funksionit dhe të gradës së tyre me funksionet organike, që ekzistojnë në Forcat e Armatosura, në çastin kur ushtarakut i lind e drejta e përfitimit të këtij trajtimi.

4. Bashkelidhur dhe pjese e pandare e udhezimit, jane formularët tip (Mod.1, Mod.2, Mod.3) te Ministrise se Mbrojtjes dhe te ISSH, mbi bazen e te cilave do te behen veprimet administrative, per efekt te llogaritjes se perfitimeve financiare.

5. Per ndjekjen dhe zbatimin e ketij Udhezimi, ngarkohen Drejtoria e Burimeve Njerezore, Arsimimit, Marredhenieve me Publikun dhe Informimit, Drejtoria e Planifikimit, Programimit dhe Buxhetimit, Drejtoria e Personel Organizimit ne Ministrine e Mbrojtjes dhe Drejtoria e Perfitimeve e Institutit te Sigurimeve Shoqerore.

Ky udhëzim hyn ne fuqi menjehere.





Mod. 1

K E R K E S E

PER PERFITIM TE TRAJTIMIT TE VEÇANTE FINANCIAR TE
EFEKTIVAVE LUNDRUES TE NENDETESEVE DHE POLUMBAREVE
TE FORCAVE DETARE, NE PENSION

**DREJTORISE RAJONALE TE SIGURIMEVE SHOQERORE
DEGES RAJONALE TE SIGURIMEVE SHOQERORE**

Une, i nenshkruari _____, me banim ne _____
(emer, atesia, mbiemer)

perfitoj pension pleqerie, sipas librezes se pensionit me Nr. _____. Mbeshtetur
ne ligjin nr.9361, date 24.3.2005, kerkoj te me caktohet trajtimi i veçante financiar, si
efektiv lundrues i nendeteseve dhe polumbareve te Forcave Detare, ne pension dhe sipas
VKM nr.69, date 27.01.2006, deklaroj se vitet e fundit te sherbimit i kam patur ne repartin
ushtarak Nr. _____, nga data _____ deri ne daten _____ ne
funksionin _____.

Bashkelidhur, dorezoj : çertifikate lindje me fotografi.

_____ me _____ 200

KERKUESI

(_____)
(Emri, atesia, mbiemri)

Punonjesi i DRSSH DSSH ploteson:

Nr. kerkeses _____.

Data e regjistrimit, ose e dergimit me poste _____.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MBROJTJES

Nr. _____ Prot. _____

Mod.2
Plotësohet nga Dikasteri

Tiranë, më _____

VERTETIM

PER VITE SHERBIMI PER TRAJTIM TE VEÇANTE FINANCIAR SI EFEKTIVE LUNDRUES I NENDETESEVE DHE
POLUMBAREVE, TE FORCAVE DETARE, NE PENSION

Vërtetojmë se ushtaraku në pension _____, ka vite sherbimi ne funksionet qe
(Grada, emer, atesi, mbiemer)
percaktohen ne nenin Nr.4 te Ligjit Nr.9361 datë 24.03.2005, si më poshtë:

Reparti Ushtarak ku ka sherbyer	Funksioni organik qe ka patur	Grada e Funksionit	Funksioni i njësuar	Grada e Funksionit te njësuar	Koha e sherbimit		
					Vite	Muaj	Ditë

SPECIALISTI

DREJTORI B.NJ.A.M.P.I.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MBROJTJES
Nr. _____ Prot.

Mod.3

Tirane, me ____ . ____ . ____

VERTETIM

PAGE REFERUESE PER EFEKT TE PERFITIMIT TE TRAJTIMIT TE VEÇANTE
FINANCIAR TE EFEKTIVAVE LUNDRUES TE NENDETESEVE DHE POLUMBAREVE
TE FORCAVE DETARE NE PENSION

Ushtaraku _____, qe ka dale ne pension,

Emer, atesi,mbiemer

ka ushtruar funksionin e fundit organik si efektiv lundrues ne nendetese ose po
mbar _____ me graden _____

Ky funksion ne momentin e lindjes se te drejtes eshte i barasvlershem me funksionin
_____, graden _____, dhe trajtohet
financiarisht si me poshte:

Nr.	Emertimi i elementeve te pages	Paga referuese ne momentin qe i lind e drejta per perfitim (leke)
1.	Paga baze per grade, sipas viteve te sherbimit	
2.	Shtesa per kushte te veçanta pune e sherbimi	
3.	Shtesa per pune te veshtire e te demshme per shendetin	
	Totali	

Paga referuese per efekt perfitimi nga Ligji Nr.9361 eshte _____
(_____)leke.

DREJTORI B. NJ.A.M.P.I

DREJTORI P.P.B.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
MINISTRI

U R D H Ë R

Nr. 253, Datë 27/08/2008

PËR
NJË NDRYSHIM NË URDHËRIN E MINISTRIT TË MBROJTJES
NR.996, DATË 01.08.2006 "PËR NJËSIMIN E FUNKSIONEVE DHE
GRADAVE TË OFICERËVE DHE NËNOFICERËVE LUNDRUES TË
NËNDETËSVE DHE POLUMBARËVE TË FORCAVE DETARE"

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, pikës 2, të nenit 19 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, nenit 6 të ligjit nr.9361, datë 24.03.2005 "Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave oficerë e nënoficerë lundrues, të nëndetësve dhe polumbarëve të Forcave Detare në pension", nenit 112, 128 të ligjit nr.8485, datë 12.05.1999 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Në urdherin e Ministrit të Mbrojtjes nr.996, datë 01.08.2006, të bëhet ky ndryshim:

- Në tabelën e pikës 1, "Shtabi i Brigadës së Nëndetseve" në pikën 15 për funksionin organik "Zv/Komandant për Teknikën dhe shef i sek.teknik", grada "Kap. Rang.III" të bëhet "Kap. Rang.II". *N/Kolonel*

2. Ndjek zbatimin e këtij urdhëri Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Arsimimit, Marrëdhënieve me Publikun dhe Informimin dhe Drejtoria e Personel-Organizimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 01.08.2006.

MINISTRI

Fatmir Mediu
FATMIR MEDIU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
MINISTRI

URDHER
Nr. 996, date 1.8. 2006

PER
NJESIMIN E FUNKSIONEVE DHE GRADAVE TE OFICEREVE DHE
NENOFICEREVE LUNDRUES TE NENDETESVE DHE POLUMBAREVE TE
FORCAVE DETARE

Ne mbeshtetje te pikes 4 te nenit 102, te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise, pikes 2 te nenit 19 te ligjit 8671, date 26.10.2000 "Per pushtetet dhe autoritetet e komandimit e te drejtimit strategjik te Forcave te Armatosura te Republikes se Shqiperise", te nenit 6 te ligjit nr.9361 date 24.03.2005 "Per nje trajtim te veçante financiar te efektivave oficer e nenoficere lundrues, te nendetesve dhe polumbareve te Forcave Detare ne pension",

URDHEROJ

1.Per efekt te trajtimit te veçante financiar te efektivave oficer e nenoficere lundrues, te nendeteseve dhe polumbareve te Forcave Detare ne pension" njeshohen funksionet si me poshte:

N R	FUNKSIONI ORGANIK EKZISTUES	GRADA E NJESUAR
	KOMANDA E BRIGADES SE NENDETSEVE	
01	Komandanti i Brigades ND.	Kap.Rang.I
02	Komisar i Brigades ND.	Kap.Rang.I
03	Zv/Komandant i Brigades ND.	Kap.Rang.II
APARATI I BYROSE SE PARTISE		
01	Sekretari i Byrose	Kap.Rang.I
02	Zv/Sekretari i Byrose	Kap.Rang.II
03	Instruktor Partie	Kap.Rang.III
04	Sekretari i Komitetit te Rinise	Kap.Rang.III
SHTABI I BRIGADES SE NENDETSEVE.		
01	Shefi i Shtabit	Kap.Rang.II
02	Shef Operativ dhe zv/shef i shtabit	Kap.Rang.III
03	Shefi i Stervitjes	Kap.Rang.III

06	Zv/Shef i Mine Silures dhe kom.i reparteve te perg. e ruajtjes se minave e silurave	K/Lejtnant
07	Shef i Nderlidhjes	Kap.Rang.III
08	Zv/Shef i Nderlidhjes	K/Lejtnant
09	Shef i Sherbimit Radio Teknik	Kap.Rang.III
10	Zv/Shef i Sherbimit Radio Teknik	K/Lejtnant
11	Shef i Zbulimit	Kap.Rang.III
12	Shef i Kimise	Kap.Rang.III
13	Shef i Kuadrit dhe Organizim Mobilizimit	Kap.Rang.III
14	Shef i Kultures dhe Propagandes	K/Lejtnant
15	Zv/Komandant per Tekniken dhe shef i sek.teknik	Kap.Rang.III
16	Zv/Shef i sek. Teknik dhe per perg. Polumbare	K/Lejtnant
17	Shef i Shendetesise- Fiziolog	Kap.Rang.III
18	Zv/Shef i Sigurimit	K/Lejtnant
FUNKSIONET ORGANIKE TE NENDETSSES		
01	Komandanti i nendetses	Kap.Rang.II
02	Komisari i nendetses	Kap.Rang.II
03	Ndihmes Komandant i nendetses	Kap.Rang.III
04	Nd/Mjek i nendetses Fiziolog	K/Lejtnant
05	Komandanti i organit luftarak Nr.1	K/Lejtnant
06	Nd/Komandant i organit luftarak 1	Lejtnant
07	Specialist per timonat horizontal dhe pergjegjes kuverte	Kapter
08	Specialist per timonat vertical, komandant i Skuadres	Rreshter
09	Specialist elektrodrejtues	Rreshter
10	Komandant i organit luftarak Nr. 3	K/Lejtnant
11	Komandant i Grupit te Silures	Lejtnant
12	Specialist per Siluren dhe Komandant i Skuadres	Kapter
13	Kryesilurist teknik	Rreshter
14	Elektrosilurist teknik	Rreshter
15	Komandanti Grupit Radiotelegrafist	Rreshter
16	Kryeradiotelegrafist	Tetar
17	Komandanti i organit luftarak Nr-5	Kap.Rang.III
18	Komandant i Grupit levizes	K/Lejtnant
19	Komandanti Grupit Motorrist	Lejtnant
20	Ndihmes komandanti Grupit Motorrist	Kapter
21	Komandanti i skuadres motoriste	Rreshter
22	Komandant i Grupit Hambarist	Kapter
23	Komandant i Skuadres Hambariste	Rreshter
24	Komandanti Grupit Elektrik	Lejtnant
25	Nd/Komandant i Grupit Elektrik	Kapter
26	Komandant i Skuadres Elektrike	Rreshter
27	Komandant i Grupit te Sherbimit Radioteknik	Kapter
28	Komandant i Skuadres Radiometriste	Rreshter
ANIJA POLUMBARE		

I Kom i anijes polumbare Kap/Lej

02	Kryepolumbari i Anijes Polumabre	Kapter
03	Polumbari i Anijes Polmbare	Rreshter
04	Ndihmes mjek fiziolog ne Polumbare	Lejtnant
	GRUPI I ZBULIMIT	
01	Komandant i Gr. Zbulimit	Lejtnant
02	Zv/Komandant i Gr. Zbulimit	Kapter

2. Ndjekin zbatimin e urdherit Drejtoria e Burimeve Njerzore, Arsimimit, Mardhenieve me Publikun dhe Informimin dhe Drejtoria e Personel Organizimit.

Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.

